

STATUTI I SHOQËRISË AKSIONARE “KAYO”

KREU I THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, SELIA

Neni 1 Data e themelimit, emri dhe themeluesit

- (1) Sot, më 24. 05. 2024, krijohet një shoqëri shtetërore aksionare me emrin “KAYO”, e pasuar në mënyrë të pandashme nga shkurtimi “Sh.A.”, që përfaqëson formën e saj ligjore, duke u referuar në vijim si “Shoqëria”.
- (2) Shoqëria është një person juridik shqiptar që ka formën ligjore të shoqërisë aksionare, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe ligjit nr. 88/2024, “Për krijimin e shoqërisë shtetërore për prodhimin dhe tregimin e armëve, munitioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake”.
- (3) Autoriteti publik që përfaqëson shtetin si aksionar të Shoqërisë, është ministria përgjegjëse për mbrojtjen.
- (4) Aksionari i Shoqërisë gëzon përgjegjësi të kufizuar deri në kufirin e kontributit në kapitalin e Shoqërisë, të përfaqësuar nga aksionet.
- (5) Në të gjitha dokumentet, faturat, reklamat dhe publikimet e Shoqërisë, pavarësisht mjetit të transmetimit, emri i Shoqërisë do të paraprihet ose do të ndiqet nga fjalët, si në vijim:
- fjalët “Shoqëri Aksionare” ose “Sh.A.”;
 - numri i saj unik i identifikimit (NIPT);
 - selia e saj.
- (6) Shoqëria ka stemën, logon dhe vulën e saj zyrtare, të cilat miratohen nga Asambleja e Përgjithshme, me propozimin e Këshillit Mbikëqyrës.

Neni 2 Objekti

Shoqëria ka objekt veprimtarie projektimin, prodhimin, riparimin, demilitarizimin, asgjësimin dhe tregtimin, brenda dhe jashtë vendit, të të gjitha llojeve të armëve ose pjesëve të armëve, përfshirë edhe armët ushtarake, të munitioneve, të teknologjive dhe pajisjeve ushtarake, uniformat, mjetet, pajisjet dhe sistemet e armatimit e komunikimit si dhe çdo aktivitet të lidhur me këtë veprimtari, në funksion të politikave kombëtare të sigurisë e mbrojtjes dhe rritjes së kapaciteteve ushtarake. Përgjatë zhvillimit të veprimtarisë së saj, Shoqëria ndjek gjithashtu interesa ekonomikë dhe tregtarë.

Neni 3 Objektivat kryesore


(1) Objektivat kryesore të aktivitetit të Shoqërisë janë, si më poshtë:

- a) projektimi, prodhimi, riparimi, demilitarizimi, asgjësimi dhe tregtimi, brenda dhe jashtë vendit, të të gjitha llojeve të armëve ose pjesëve të armëve, përfshirë edhe armët ushtarake, municioneve, teknologjite dhe pajisjeve ushtarake, uniformat, mjetet, pajisjet dhe sistemet e armatimit e komunikimit, si dhe çdo aktivitet të lidhur me këtë veprimtarri, në funksion të politikave kombëtare të sigurisë e mbrojtjes dhe rritjes së kapaciteteve ushtarake;
 - b) ngritja, zhvillimi dhe forcimi i industrisë së prodhimit e të tregtimit të armëve, me qëllim sigurimin e nevojave të Forcave të Armatosura dhe ato të sigurisë në Republikën e Shqipërisë, si dhe të realizimit të fitimit ekonomik;
 - c) prodhimi dhe furnizimi me për pajisje të nevojshme Forcat e Armatosura dhe strukturat e tjera përgjegjëse të sigurisë për të garantuar mbrojtjen dhe sigurinë e interesave kombëtare;
 - ç) ndërtimi, zhvillimi dhe përmirësimi i kapaciteteve vendase për të prodhuar e furnizuar Forcat e Armatosura dhe strukturat e tjera përgjegjëse të sigurisë me pajisje të nevojshme për operacionet e tyre;
 - d) mobilizimi i kapitalit shtetëror dhe/ose privat në funksion të zhvillimit të aktivitetit të saj;
 - dh) nxitja e investimeve në teknologji dhe inovacion për prodhimin, përdorimin, tregtimin e armëve brenda dhe jashtë vendit;
 - e) bashkëpunimi me subjekte të ndryshme shtetërore e private, kombëtare dhe ndërkombëtare, për zhvillimin e objektit të veprimitarisë së saj;
 - ë) financimi ose bashkëfinancimi i projekteve në fushën e mbrojtjes e të sigurisë kombëtare ose shoqëri të themeluara në bashkëpunim me subjekte private dhe/ose publike të ngritura për realizimin e tyre.
- (2) Gjithashtu, në përputhje me legjislacionin në fuqi, Shoqëria do të kryejë çdo operacion tregtar dhe finanziar që lidhet me aktivitetin e saj. Kjo përfshin gjithashtu edhe të drejtën të krijojë struktura të tjera sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Neni 4 Funkcionet e Shoqërisë

Funkcionet kryesore të Shoqërisë janë, si më poshtë:

1. Prodhimi, riparimi, demilitarizimi dhe tregimi i armëve ose i pjesëve të armëve, përfshirë edhe armët ushtarake, municionet, teknologjite dhe pajisjet ushtarake, uniformat, mjetet, pajisjet dhe sistemet e armatimit e komunikimit, si dhe çdo aktivitet të lidhur me këtë veprimtarri, në funksion të politikave kombëtare të sigurisë dhe mbrojtjes, të politikave shtetërore të rritjes së kapaciteteve ushtarake, si dhe të zhvillimit të industrisë ushtarake.
2. Bashkëpunimi me Forcat e Armatosura, me qëllim fuqizimin dhe rritjen e kapaciteteve të tyre ushtarake, nëpërmjet sigurimit të armëve, teknologjive dhe pajisjeve ushtarake për Forcat e Armatosura nga ana e Shoqërisë, në cilësinë e furnizuesit, të agjentit ose të autoritetit kontraktor, në përputhje me legjislacionin në fuqi.



3. Tregimi nga vetë Shoqëria apo nga subjekte të tjera të themeluara prej saj ose në bashkëpunim me subjekte private i armëve ushtarake, ose i pjesëve të tyre, i munizioneve, teknologjive dhe pajisjeve ushtarake, të prodhura në territorin e Republikës së Shqipërisë,
4. Financon ose bashkëfinancon projekte ose shoqëri të themeluara në bashkëpunim me subjekte private dhe/ose publike, me qëllim realizimin e objektit të veprimitarisë së saj.

Neni 5
Selia

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: "Garnizoni Skënderbej", Rruga e Dibrës dhe ka të drejtën të krijojë struktura të tjera sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

KREU II
KAPITALI

Neni 6
Kapitali themeltar dhe kontributet në kapital

- (1) Kapitali i Shoqërisë është 100 % shtetëror.
- (2) Kapitali themeltar i Shoqërisë është i barabartë me shumën **150.000.000 (njëqindpesëdhjetë milionë)** lekë.
- (3) Kapitali themeltar është i ndarë në **100** (njëqind) aksione të zakonshme me një vlerë nominale prej **1.500.000** (një milion e pesëqindmijë) lekë secila, të cilat përfaqësojnë 100% të kapitalit aksionar të Shoqërisë ("Aksionet e MM-së").

Neni 7
Zmadhimi i kapitalit themeltar

- (1) Kapitali i regjistruar i Shoqërisë mund të zmadhohet, duke emetuar aksione rishtazi përkundrejt kontributeve të reja, të nënshkruara vetëm nga aksionari i vetëm.
- (2) Zmadhimi i kapitalit mund të kryhet edhe nëpërmjet aktiveve të shoqërisë. Pas miratimit të bilancit të vitit paraardhës, aksionari i vetëm mund të vendosë ta zmadhojë kapitalin e regjistruar, duke kaluar në kapitalin bazë rezervat e disponueshme dhe fitimet e shpërndara.
- (3) Shoqëria do të njoftojë QKB-në për vendimin e miruar lidhur me zmadhimin e kapitalit, në përputhje me afatet e parashikuara nga ligji nr. 131/2015, "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit". Zmadhimi i kapitalit do të hyjë në fuqi në datën e regjistrimit të realizimit pranë QKB-së.

Neni 8
Zvogëlimi i kapitalit themeltar

- (1) Kapitali i regjistruar i Shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të aksionarit të vetëm, në përputhje me përcaktimet e pikës 1, të nenit 145, të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

(2) Zvogëlimi i kapitalit realizohet nëpërmjet zvogëlimit të vlerës nominale të aksioneve dhe anulim aksionesh.

(3) Kapitali i regjistruar mund të zvogëlohet nën vlerat minimale, të parashikuara në ligj, vetëm në rastin kur zvogëlimi shoqërohet me një zmadhim të njëkohshëm të kapitalit.

KREU III ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

Neni 9 Organet e Shoqërisë

Organet e Shoqërisë janë:

1. Asambleja e përgjithshme;
2. Këshilli Mbikëqyrës;
3. Administratori.

Neni 10 Asambleja e Përgjithshme

(1) Ministri i Mbrojtjes, në cilësinë e përfaqësuesit të aksionarit të vetëm, ushtron të gjitha kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme të parashikuara nga ligji "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", që nuk janë shprehur në këtë statut.

(2) Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të Shoqërisë:

- a) miratimin e statutit të Shoqërisë dhe të ndryshimeve të tij, me propozimin e Këshillit Mbikëqyrës;
- b) miratimin e strategjisë së zhvillimit të Shoqërisë, me propozimin e Këshillit Mbikëqyrës, në përputhje me politikat dhe dokumentet strategjike të mbrojtjes dhe sigurisë;
- c) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë së Shoqërisë;
- ç) emërimin, lirimin dhe pranimin e dorëheqjes së anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës;
- d) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- dh) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
- e) çështje të tjera të parashikuara nga ligji "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", që nuk janë përmendur në këtë statut.

(3) Asambleja e Përgjithshme merr vendime pas shqyrtimit të dokumenteve përkatëse, së bashku me reportin e Këshillit Mbikëqyrës dhe/ose raportet e ekspertit kontabël.

(4) Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose fshihen. Vendimet e paregjistruara janë absolutisht të pavlefshme.

Neni 11

Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

- (1) Asambleja e Përgjithshme mblidhet në rastet e përcaktuara në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ligjin nr. 88/2024, "Për krijimin e shoqërisë shtetërore për prodhimin dhe tregimin e armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake", dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme, mbahet në selinë e Shoqërisë, ose në çdo vend tjetër për të cilin është rënë dakord.
- (2) Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nga aksionari, nga anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës ose nga administratori. Mbledhja mund të thirret gjithashtu nga eksperti kontabël në rastet kur parashikohet nga legjislacioni në fuqi.
- (3) Asambleja e Përgjithshme do të thirret të paktën një herë në vit, për të aprovuar llogaritë vjetore, brenda 6 muajve nga mbarimi i vitit ushtrimor, si dhe për të ushtruar çdo kompetencë që i jep ligji.
- (4) Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme është e detyrueshme në rastin e ngjarjeve të parashikuara nga neni 136, i ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 12 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme

- (1) Vendimet merren nga aksionari i vetëm i Shoqërisë.
- (2) Administratori ose anëtar i Këshillit të Mbikëqyrës, pavarësisht se nuk është aksionar, ka të drejtën e pjesëmarrjes, si edhe të marrë fjalën në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 13 Këshilli Mbikëqyrës

- (1) Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë.
- (2) Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës emërohen dhe lirohen nga Asambleja e Përgjithshme, pas propozimit të institucioneve të përmendura në pikën 7 të këtij neni, me afat emërimi 3 (tre) vjet dhe me të drejtë rizgjedhje. Ata mund të lirohen nga Asambleja e Përgjithshme për shkaqe të parashikuara në nenin 18 të këtij statuti.
- (3) Anëtarët ndryshohen nga Asambleja e Përgjithshme në rast se ndryshon funksioni që përfaqësojnë.
- (4) Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës nuk mund të jenë pjesëmarrës në më tepër se 2 (dy) këshilla mbikëqyrës të një shoqërie aksionere shtetërore në Republikën e Shqipërisë.
- (5) Këshilli Mbikëqyrës zgjedh, ndërmjet anëtarëve të tij, një kryetar dhe një zëvendëskryetar, të cilët thërrasin mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës dhe drejtojnë diskutimet.
- (6) Këshilli Mbikëqyrës mund të caktojë një person si sekretar edhe jashtë anëtarëve të tij.
- (7) Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga:
- 1 (një) anëtar, përfaqësues i Kryeministrisë;
 - 2 (dy) anëtarë, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për mbrojtjen;
 - 1 (një) anëtar, përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për financat;
 - 1 (një) anëtar, përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për ekonominë;

- I (një) anëtar, përfaqësues i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura;
- I (një) anëtar, përfaqësues i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

(1) Personat e emëruar si anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës janë:

1. **Z. Ermal Nufi**, i datëlindjes 12.05.1988, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal I80512071K, emërohet anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë "KAYO" sh.a., në cilësinë e përfaqësuesit të Kryeministrisë.
2. **Z. Eldi Condi**, i datëlindjes 18.11.1986, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal I61118038K, emërohet anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë "KAYO" sh.a., në cilësinë e përfaqësuesit të Ministrisë së Financave.
3. **Znj. Ilda Malile**, i datëlindjes 16.09.1975, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal H55916041E, emërohet anëtare e Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë "KAYO" sh.a., në cilësinë e përfaqësuesit të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.
4. **Nënkolonel Ervin Feti**, i datëlindjes 14.02.1983, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal I30214188K, emërohet anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë "KAYO" sh.a., në cilësinë e përfaqësuesit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.
5. **Z. Grestian Poci**, i datëlindjes 24.03.1980, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal I00324068N, emërohet anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë "KAYO" sh.a., në cilësinë e përfaqësuesit të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.
6. **Z. Aleks Marku**, i datëlindjes 18.07.1980, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal I00718074Q, emërohet anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë "KAYO" sh.a., në cilësinë e përfaqësuesit të Ministrisë së Mbrojtjes.
7. **Z. Gjergji Methoxha**, i datëlindjes 26.11.1981, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal I11126046N, emërohet anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë "KAYO" sh.a., në cilësinë e përfaqësuesit të Ministrisë së Mbrojtjes.

Neni 14 Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës

Këshilli Mbikëqyrës siguron që Shoqëria gjëzon autonomi operacionale në veprimtarinë e saj dhe ka këto kompetenca:

- a) propozon për miratim në Asamblenë e Përgjithshme statutin e Shoqërisë dhe ndryshimet në të;
- b) propozon për miratim në Asamblenë e Përgjithshme strategjinë e zhvillimit të Shoqërisë;
- c) miraton strukturën dhe organikën e shoqërisë,
- ç) miraton planin e biznesit dhe planet vjetore të punës;
- d) miraton projektet e investimit;
- dh) miraton ngritjen e strukturave të tjera të Shoqërisë;
- e) kontrollon e mbikëqyr zbatimin e politikave dhe të projekteve të investimit të Shoqërisë;
- ë) miraton treguesit e performancës dhe monitoron performancën e saj;
- f) siguron që auditimi i Shoqërisë të kryhet për të respektuar dhe për të dhënë në çdo kohë garancitë që Shoqëria ka marrë përsipër, sidomos ato në fushën e sigurisë e të mbrojtjes;
- g) përcakton pagat dhe shpërblimin e organeve dhe të administratës së Shoqërisë;

- gj) krijon komitete të posaçme lidhur me kontrolllet e brendshme, përputhshmërinë ligjore dhe etike në Shoqëri;
- h) miraton procedurat për kontraktimin e konsulentëve dhe të bashkëpunëtorëve të jashtëm të Shoqërisë, me kërkesë të administratorit;
- i) miraton aktet e brendshme rregullatore të Shoqërisë;
- j) miraton procedurat e hollësishme konkurruese, kriteret për negocimin, raportin e grupit negociator, si dhe autorizimin për lidhjen e kontratave me subjekte juridike, private apo publike, në përputhje me parashikimet e këtij ligji, legjislacionin kombëtar e ndërkombëtar, të aplikueshëm për prodhimin e tregtimin e armëve;
- k) miraton procedurat dhe kriteret për emërimin e personelit, si dhe një rregullore të veçantë mbi masat për ruajtjen e të dhënave të klasifikuara dhe të sekretit tregtar të veprimtarisë së Shoqërisë, format e kontrollit të vazhdueshëm lidhur me marrjen e masave dhe procedurën e mundshme administrative e penale, që ndiqet në rast shkeljeje të këtyre rregullave.
- l) detyra të tjera të parashikuara nga ligji nr. 88/2024, "Për krijimin e shoqërisë shtetërore për prodhimin dhe tregtimin e armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake", ligji nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe aktet nënligjore në zbatim të tyre.

(2) Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës udhëhiqen nga parimi i mirëbesimit, duke përfshirë detyrimin për kujdesin, besnikërinë, konfidencialitetin, integritetin dhe pavarësinë në raport me Shoqërinë.

Neni 15

Kriteret e emërimit, paga dhe shpërblimi i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës

- (1) Anëtari i Këshillit Mbikëqyrës propozohet dhe zgjidhet, duke plotësuar këto kriterë:
 - a) të jetë shtetas shqiptar
 - b) të ketë minimalisht arsim të lartë të nivelit të dytë;
 - c) të ketë një përvojë pune për të paktën 7 (shtatë) vjet në fushën e biznesit, financave, drejtësisë ose në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë;
 - ç) të mos ketë qenë i dënuar penalisht për kryerjen e një vepre penale me karakter ekonomiko-financiar;
 - d) të ketë cilësi të larta morale dhe profesionale;
 - dh) të mos kenë interesa të drejtpërdrejta ose tërthorta që mund të krijojnë konflikt interesit me detyrat mbikëqyrëse;
- (2) Për pjesëmarrjen në Këshillin Mbikëqyrës, kryetari merr një pagë mujore në masën 30 % të pagës mujore të administratorit të Shoqërisë dhe anëtarët marrin një pagë mujore në masën 20 % të pagës mujore të administratorit të Shoqërisë.
- (3) Me propozim të administratorit dhe miratim të Asamblesë së Përgjithshme, anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës u caktohen shpërblime suplementare në formën e pagesave të veçanta për angazhime specifike përtëj detyrave funksionale dhe shpërblime të posaçme, bazuar në performancën dhe arritjen e rezultateve të larta të Shoqërisë.

Neni 16

Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës

- (1) Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës mbahen të paktën 1 (një) herë në 3 (tre) muaj, si dhe sipas nevojave të aktivitetit tregtar të Shoqërisë.
- (2) Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës merren me kuorumin e përcaktuar në pikën 5, të nenit 167 dhe nenin 162, të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".
- (3) Çështjet e rendit të ditës vendosen me shumicën e votave të pjesëmarrësve. Në rast numri të barabartë votash, vota e kryetarit do të jetë vendimtare.
- (4) Vendimi me shkrim i nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të cilët kanë të drejtë të njoftohen për mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës, është njëloj i vlefshëm dhe i efektshëm sikur të ishte miratuar në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës të mbledhur dhe të zhvilluar rregullisht.

Neni 17
Procesverbalet e Këshillit Mbikëqyrës

- (1) Këshilli Mbikëqyrës është përgjegjës për mbajtjen në libra të posaçëm të procesverbaleve të mbledhjeve të tij.
- (2) Prosesverbalet e çdo mbledhjeje mbahen nga sekretari dhe depozitohen në Shoqëri.

Neni 18
Largimi i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës

Detyra e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës përfundon në rast se:

1. Pushon së qeni anëtar i Këshillit Mbikëqyrës në bazë të dispozitave të ligjit, duke përfshirë parashikimet e pikës 4, të nenit 167 dhe nenit 157.
2. Bëhet i paaftë fizikisht ose juridikisht për të përm bushur detyrën e tij (sëmundje të rënda, procese penale etj.).
3. Institucioni i përfaqësuar/propozues propozon lirimin.
4. Jep dorëheqjen.
5. Nuk plotëson kushtet për pajisje me certifikatë sigurie.
6. Mungon në më shumë se 2 (dy) mbledhje radhazi, pa konfirmimin e anëtarëve të tjera të Këshillit Mbikëqyrës. Në këtë rast, Asambleja e Përgjithshme, me propozim të Këshillit Mbikëqyrës, vendos ta shkarkojë nga detyra.
7. Kryen shkelje të rënda të detyrimeve ndaj Shoqërisë.

Neni 19
Administratori

- (1) Asambleja e Përgjithshme emëron administratorin e Shoqërisë, për një afat 3-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.
- (2) Emërimi prodhon pasoja pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- (3) Administratori, gjatë ushtrimit të kësaj detyre në këtë Shoqëri, nuk mund të emërohet administrator në shoqëri të tjera tregtare.
- (4) Administratori përzgjidhet duke plotësuar këto kritere:
 - a) të jetë shtetas shqiptar;

- b) tē ketē minimalisht arsim tē lartē tē nivelist tē dytē;
- c) tē ketē një përvojë pune pér tē paktën 7 (shtatë) vjet në fushën e biznesit, financave, manaxhimit, drejtësisë ose në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.
- d) tē këtë integritet tē lartë moral dhe profesional;
- e) tē mos ketë qenë i dënuar penalisht pér kryerjen e një vepre penale me karakter ekonomiko-financiar;
- f) tē ketë cilësi tē larta morale dhe profesionale;
- g) tē mos kenë interesa tē drejtpërdrejta ose tërthorta që mund tē krijojnë konflikt interesit me detyrat mbikëqyrëse.

(5) Administratori i Shoqërisë zgjidhet nëpërmjet një procesi që duhet tē garantojë një procedure transparente, ligjore dhe tē mbështetur në kriteri objektive:

- në rast nevoje pér përzgjedhjen e një administratori tē ri, Asambleja e Përgjithshme siguron që procedura përzgjedhëse tē përfundojë brenda 30 ditëve nga largimi i administratorit paraardhës;
- Asambleja e Përgjithshme krijon komitetin e posaçëm, me qëllim identifikimin dhe propozimin e 5 (pesë) kandidaturave tē përshtatshme në përputhje me kriteret e përcaktuara nga ky statut. Anëtarët e komitetit tē posaçëm janë punonjës në nivelet e larta drejtuese të Shoqërisë;
- Komiteti i posaçëm paraqet propozimet e shoqëruara me raportet përkatëse brenda 15 ditëve nga marrja e detyrës;
- Asambleja e Përgjithshme, brenda 10 ditëve nga marrja e propozimeve, kryen verifikimet e nevojshme, përfshirë këtu edhe intervistat e kandidaturave;
- në përfundim tē këtij procesi, Asambleja e Përgjithshme emëron administratorin e ri tē Shoqërisë.

(6) Administratori i parë i Shoqërisë caktohet Z. Ardi Veliu, i datëlindjes 02.03.1972, mbajtës i letërmjofimit me numër personal H20302175F.

Neni 20 **Kompetencat e administratorit**

Administratori i Shoqërisë:

- a) kryen tē gjitha veprimet e administrimit tē veprimtarisë tregtare tē Shoqërisë;
- b) përfaqëson Shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset pér mbajtjen e saktë e tē rregullt tē dokumenteve dhe tē librave kontabël tē Shoqërisë;
- ç) përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, tē cilët ia paraqesin Këshillit Mbikëqyrës pér miratim, së bashku me propozimet pér shpërndarjen e fitimeve, pér t'u paraqitur më pas pér miratim nga Asambleja e Përgjithshme;
- d) krijon një sistem monitorimi e njoftimi tē hershëm pér rrëthanat, që kërcënojnë ekzistencën e Shoqërisë;
- dh) kryen regjistrimet e publikimet e detyrueshme tē tē dhënavë tē Shoqërisë, sipas parashikimeve ligjore;
- e) raporton përpëra Këshillit Mbikëqyrës pér zbatimin e politikave dhe veprimtarinë e Shoqërisë;
- ë) kryen detyra tē tjera, tē papërmendura në këtë statut dhe tē parashikuara në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar dhe ligjin nr. 88/2024,

"Për krijimin e shoqërisë shtetërore për prodhimin dhe tregtimin e armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake", dhe aktet nënligjore në zbatim të tyre.

Neni 21 Shkarkimi i administratorit të Shoqërisë

Detyra e administratorit përfundon në rast se:

1. Personi nuk është më administrator në bazë të dispozitave të ligjit, përfshirë shkarkimin nga Asambleja e Përgjithshme, në pajtim me pikën 2, të nenit 167, dhe shkronjën "c", të pikës 2, të nenit 135 të ligjit;
2. Bëhet i paaftë fizikisht ose juridikisht për të përmbrashur detyrën e tij (sëmundje të rënda, procese penale etj.).
3. Jep dorëheqjen.
6. Kryen shkelje të rënda të detyrimeve ndaj Shoqërisë.
7. Nuk plotëson kushtet për pajisje me certifikatë sigurie.
5. Ka humbur besueshmérinë e aksionerit gjatë ushtrimit të detyrës së tij për administrimin e Shoqërisë.

Neni 22 Konflikti i interesit

(1) Të gjithë personat e punësuar pranë Shoqërisë, përfshirë edhe organet drejtuese, nuk mund të angazhohen në aktivitete private të lidhura me prodhimin, tregtimin ose shpërndarjen e armëve, brenda ose jashtë vendit. Këto aktivitete përfshijnë, por nuk kufizohen në dypunësimin në shoqëri të tjera private të armëve, lidhen e kontratave private për prodhimin ose tregtimin e armëve, si dhe dhënien e shërbimeve të konsulencës lidhur me industrinë e armëve.

(2) Në rastin e shkëputjes së marrëdhënies së punës me Shoqërinë, punonjësi është i ndaluar të angazhohet në një aktivitet konkurrues me veprimtarinë e Shoqërisë për një periudhë pesëvjeçare nga data e shkëputjes së marrëdhënies së punës.

Neni 23 Ushtrimi finansiar

Ushtrimi finansiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti.

Përashtimisht, ushtrimi i parë finansiar përfshin kohën nga data e regjistrimit në regjistrin tregtar deri më 31 dhjetor.

Neni 24 Eksperti kontabël i autorizuar

Kontrolli i Shoqërisë ushtrohet nga ekspertë kontabël të autorizuar, të cilët emërohen nga aksionari i vetëm dhe që kryejnë misionin e tyre në pajtim me ligjin.

Ekspert kontabël i parë i caktuar nga aksionari themelues do të jetë Znj. Diana Ylli me Nr.Rregjistrimi E.K.R Nr. 09 Dt.11.01.2000, MAZARS sh.p.k me NIPT K32123006E.

KREU IV
DIVIDENDËT DHE KALIMI I FITIMEVE NË KAPITALIN THEMELTAR

Neni 25
Inventari – llogari vjetore

Shoqëria do të mbajë një kontabilitet të rregullt të pasurisë dhe të veprimtarisë së saj në pajtim me kërkesat ligjore. Në mbylljen e ushtrimit, administratori harton inventarin e pasurisë në këtë datë dhe llogaritë vjetore për ushtrimin financiar. Administratori përgatit gjithashtu edhe raportin e administrimit për gjendjen e shoqërisë gjatë ushtrimit financiar.

Neni 26
Dividendët

- (1) Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë shpërndarjen e dividendëve, në përputhje me dispozitat e ligjit.
- (2) Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me aksionet, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhën në përputhje me shumën e paguar për aksionet për të cilët paguhet dividendi.
- (3) Asnjë dividend ose pagesë në para që lidhet me një aksion nuk prodhon interesa kundrejt Shoqërisë, nëse një gjë e tillë nuk parashikohet në të drejtat e aksionit.
- (4) Çdo dividend që nuk është kërkuar të paguhet brenda dymbëdhjetë vjetëve nga data e maturimit, në rast se vendoset nga Asambleja e Përgjithshme, do të përfitohet nga Shoqëria, e cila nuk do të jetë më e detyruar që ta paguajë atë.

Neni 27
Kalimi i fitimeve në kapitalin themeltar

Administratori, pas vendimit të marrë nga Asambleja e Përgjithshme, mund të vendosë të kalojë në kapitalin themeltar të Shoqërisë fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividendë preferencialë apo shuma të tjera të parashikuara për rezerva ligjore ose kapitali.

Neni 28
Rezultati ushtrimor dhe përcaktimi i fitimit

- (1) Rezultati i ushtrimit përcaktohet si diferençë ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve të ushtrimit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm.
- (2) Nga fitimet e ushtrimit, të pakësuara kur është rasti me humbjet e mëparshme, hiqet të paktën 5% për të krijuar rezervën e domosdoshme.

(3) Heqja nga fitimet për rezervën e domosdoshme nuk është e detyrueshme, kur kjo rezervë arrin 1/10 e kapitalit themeltar. Ajo rifillon për një arsyё çfarëdo, kur rezerva e domosdoshme ka zbritur nën 1/10 e kapitalit.

(4) Përdorimi i fitimit pas zbritjes së rezervës ligjore bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, bazuar në propozimin e Këshillit Mbikqyrës.

**KREU V
DISPOZITA TË FUNDIT**

**Neni 29
Baza ligjore**

(1) Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

(2) Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil, ligjit nr. 88/2024, "Për krijimin e shoqërisë shtetërore për prodhimin dhe tregtimin e armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake" dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Ky statut hartohet dhe nënshkruhet në gjuhën shqipe, në 4 (katër) ekzemplarë originalë, me vlerë të njëjtë ligjore, njeri prej të cilëve do të depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

**Neni 30
Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente gjykata e rrëthit gjyqësor Tiranë.

AKSIONARI THEMELUES I SHOQËRISË

MINISTRI I MBROJTEJS

Pirro Vengu